



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

V E N D I M

Nr. 649, datë 29.12.2020

PËR

KUALIFIKIMIN E KANDIDATES ZNJ. {...}

DHE VIJIMIN E PROCEDURAVE TË EMËRIMIT NË GJYKATËN E APELIT TIRANË, PËR DY POZICIONET E LIRA NË FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 181, NR. 183 DHE PËR POZICIONIN E LIRË NË FUSHËN E TË DREJTËS PENALE, TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 185, DATË 28.05.2020, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 29.12.2020, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Apelit, të kandidatës znj. {...}”, përgatitur nga relatorja znj. Marçela Shehu, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 181 dhe nr. 183 datë 28.05.2020 dhe për pozicionin e lirë, në fushën e së drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 185, datë 28.05.2020

V Ë R E N

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Me Vendimin nr. 181, datë 28.05.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile ...”.

2. Me Vendimin nr. 183, datë 28.05.2020, Këshilli ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile ...”.

3. Me Vendimin nr. 185, datë 28.05.2020, Këshilli ka vendosur:

“1. Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale ...”.

4. Në të trija këto procedura të ngritjes në detyrë për në Gjykatën e Apelit Tiranë, afati i kandidimit është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit të vendimit përkatës në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Njoftimi për hapjen e procedurave të ngritjes në detyrë është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 29.05.2020, duke përfunduar kështu afati i kandidimit më datë 15.06.2020.

5. Brenda afatit të kandidimit ka kandiduar edhe znj. {...} (më poshtë referuar si kandidati), gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

6. Me Vendimin nr. 238, datë 07.07.2020, “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 28.05.2020”, Këshilli ka vendosur:

“1. Fillimin e procedurës së verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet nr. 173, nr. 174, nr. 176, nr. 179, nr. 180, nr. 181, nr. 182, nr. 183, nr. 184, nr. 185, nr. 186, nr. 187 dhe nr. 188, datë 28.05.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

2. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: ...

...2. Për kandidaten znj. {...} - relatore znj. Marçela Shehu; ...”.

7. Më datë 07.07.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidatja u njoftua:

- për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit;
- për caktimin e relatores së kësaj procedure verifikimi;
- për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatores së caktuar dhe/ose të çdo anëtari tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

8. Brenda afatit të përcaktuar kandidatja nuk parashtrroi ndonjë pretendim në lidhje me relatoren e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj saj apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

9. Më datë 09.07.2020, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, në rrugë elektronike, kandidates iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej saj në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

10. Brenda afatit pesëditor, kandidatja depozitoi rregullisht dokumentacionin e kërkuar të kandidimit, pranë Zyrës së Protokollit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ndërsa një nga dokumentet, pikërisht formularin e deklaratës së pasurisë, sipas Vendimit 75/2019, kandidatja duhet ta dorëzonte, jo më vonë se 21 ditë nga dita e dërgimit të tij, pra deri më datë 30.07.2020, pranë ILDKPKI-së.

11. Në vijim të procedurës së verifikimit, më datë 19.05.2020, bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, për kandidatët për gjyqtar në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, ndër ta edhe për kandidaten znj. {...}. Për këto kritere ligjore kandidimi procedura e verifikimit është në proces e sipër.

12. Sipas pikës 9, të Vendimeve të Këshillit nr. 181, nr. 183 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, është përcaktuar se: *“Për kandidatin, për të cilin me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor verifikohet plotësimi i kriterëve ligjore të kandidimit sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, fillon menjëherë procesi i vlerësimit etik dhe profesional: ...”*. Ndërkohë, në pikën 5, shkronja “a”, të Vendimeve të Këshillit nr. 181, nr. 183 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, përcaktohet se: *“Kriteret ligjore që duhet të plotësojë kandidati për t’u ngritur në detyrë pranë gjykatës së shkallës së dytë përcaktohen..., si më poshtë: a) Kandidati duhet të ketë ushtruar ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës civile/penale, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar”*. Nga ana tjetër, në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 5, të këtij vendimi, përcaktohet se: *“c) Kandidati duhet të mos ketë masë disiplinore në fuqi; ç) Kandidati duhet të mos jetë në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

13. Në respektim të vendimit si më lart të Këshillit, sa i përket plotësimit të tre kriterëve formale të sipërpërmendura të kandidimit për ngritjen në detyrë në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, me qëllim realizimin paralelisht edhe të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve, pra në funksion të përmbylljes sa më parë të procedurave të kandidimit, për kandidaten znj. {...} u kërkua dhe u administrua informacioni i nevojshëm nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si organi kompetent për krijimin dhe administrimin e dosjeve personale dhe regjistrin të gjyqtarëve, si dhe nga gjykatat ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtares.

13.1 Për verifikimin e kriterëve të *“përvojës profesionale minimale”* dhe atij të *“mospasjes masë disiplinore në fuqi”*, Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, me Shkresën nr. 3189/1 prot., datë 13.07.2020, përcolli informacionin dhe dokumentacionin përkatës të administruar për kandidaten znj. {...}, siç do të përshkruhet më poshtë.

13.2 Sa i përket kriterit të *“përvojës profesionale minimale”* dhe pikërisht nënkriterit të *“përvojës specifike profesionale”* të kandidates në fushat e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionet e lira ku ajo ka kandiduar, pra në fushën e të drejtës civile dhe penale, referuar gjykatave ku kandidatja ka ushtruar funksionin e gjyqtares, informacioni u kërkua konkretisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës informacioni i kërkuar është përcjellë me Shkresën nr. 1936 prot., datë 16.07.2020, siç do të përshkruhet më poshtë.

Nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë informacioni i kërkuar është përcjellë me Shkresën nr. 86 prot., datë 17.07.2020, siç do të përshkruhet më poshtë.

14. Ndërkohë, në lidhje me kriteret e verifikimit të pasurisë dhe të figurës, pas kërkesave konkrete, Institucionet kompetente kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PARAPRAK PËR TRE KRITERET E KANDIDIMIT

15. Për kandidaten znj. {...} u verifikua kriteri i “*përvojës profesionale minimale*”.

16. “Përvoja profesionale minimale” për ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë në rastin konkret në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, që gjen reflektim në shkronjën “a”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 181, nr. 183 dhe nr. 185 datë 28.05.2020, është parashikuar si kusht kandidimi në nenin 47, pika 4, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: “*Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar*”.

17. Për verifikimin e kandidates në lidhje me plotësimin e këtij kriteri për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit (në fushën civile dhe penale) u mbajt parasysh se në këto gjykata gjykohen çështje me lëndë civile dhe penale, çka do të thotë se kandidatja, krahas përvojës së përgjithshme profesionale minimale, që është jo më pak se shtatë vjet, duhet të plotësojë edhe përvojën specifike profesionale minimale, pra jo më pak se pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionet e lira, konkretisht në fushën e të drejtës civile për pozicionin e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 181 dhe nr. 183 datë 28.05.2020 dhe në fushën e të drejtës penale për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 185, datë 28.05.2020.

18. Në lidhje me përvojën e përgjithshme profesionale, në kërkesat për shprehje interesi dhe në jetëshkrimin e dorëzuar nga kandidatja, evidentohet se ajo ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2009. Kandidatja ka kryer stazhin profesional si gjyqtare në kuadër të vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës në vitet 2007-2009 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Më pas, ajo është emëruar përfundimisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë, ku vijon të ushtrorë funksionin dhe aktualisht.

19. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...}, fillimin në detyrë e ka me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 5478 datë 05.10.2007, ku është emëruar për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, ndërsa me Dekretin e Presidentit të Republikës nr. 6108 datë 25.03.2009, ajo është emëruar përfundimisht gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë ku vijon të ushtrorë funksionin dhe aktualisht.

20. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerësoi se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 181, nr. 183 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, rezulton të ketë mbi shtatë vjet përvojë të përgjithshme profesionale si gjyqtare e gjykatës së shkallës së parë.

21. Në lidhje me përvojën specifike profesionale, në kërkesën për shprehje interesi, kandidatja ka deklaruar se ka eksperiencë të mjaftueshme në fushën e të drejtës civile dhe penale prej më shumë se 5 vjetësh.

22. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, rezulton se:

“... znj. {...}, fillimin në detyrë e ka me Dekretin nr. 5478, datë 05.10.2007, ku është emëruar për të kryer stazhin profesional pranë kësaj gjykate deri më 25.03.2009.

Në lidhje me sa kërkoni, për periudhën kohore për të cilën kërkohet informacioni për përvojën e gjyqtarës znj. {...}, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, nuk disponon urdhra të Kryetarit për ndarjen në dhoma/seksione të gjyqtarëve.

Në mungesë të tyre, bashkëngjitur kësaj shkrese, gjeni në format statistikor, llojet e vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtare znj. {...}, për periudhën 2007-2009...”.

22.1 Referuar të dhënave të regjistrimit të vendimeve civile për vitin 2007 - 2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, kandidatja znj. {...}, referuar objektit të çështjeve gjyqësore, është shortuar dhe ka gjykuar *çështje të karakterit administrativ, civil dhe penal.*

23. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, rezulton se:

“...Gjyqtarja {...}, me Dekretin nr. 6108, datë 25.03.2009 të Presidentit të Republikës është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë dhe vijon të ushtrojë këtë detyrë.

Rezulton se gjatë kësaj periudhe sipas urdhrit të kryetares së gjykatës, ajo ka gjykuar çështje të karakterit penal nga viti 2009 – 2011, më pas ajo ka gjykuar çështje të karakterit penal dhe civil pasi nuk ka patur ndarje në seksione ..”.

23.1 Referuar të dhënave të mësipërme për vitin 2006 - 2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, kandidatja znj. {...}, ka gjykuar *çështje të karakterit civil dhe penal.*

24. Nga të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerësoi se kandidatja znj. {...}, deri në momentin e kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 181, nr. 183 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, rezulton të ketë mbi pesë vjet përvojë profesionale në fushën e të drejtës civile dhe penale.

25. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

26. “Mospasja masë disiplinore në fuqi” si kriter për ngritjen në detyrë edhe në gjykatën e shkallës së dytë, që gjen reflektim në shkronjën “c”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 181, nr. 183 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, është parashikuar në nenin 48, pika 8, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Vetëm kandidatët të cilët ... nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.*

27. Në lidhje me këtë kriter, në rastin e aplikimit, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore” datë 08.06.2020, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk kam masë disiplinore në fuqi”*.

28. Sipas informacionit të përcjellë nga Departamenti i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit, kandidatja znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

29. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerësoi se nuk vërtetohet që kandidatja znj. {...} të ketë masë disiplinore në fuqi.

30. Për kandidaten znj. {...} u verifikua edhe kriteri i “papajtueshmërisë ambientale”.

31. Papajtueshmëria ambientale si kriter ndalues për ngritjen në detyrë edhe në gjykatën e shkallës së dytë, që gjen reflektim në shkronjën “ç”, të pikës 5, të Vendimeve të Këshillit nr. 181, nr. 183 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, është parashikuar në nenin 8, pika 2, të Ligjit për Statusin, ku përcaktohet se: *“Këshillat, gjatë ... ngritjes në detyrë të magjistratit, për aq sa është e mundur dhe pa cenuar në mënyrë jopropocionale të drejtën për zhvillimin normal të karrierës profesionale të magjistratit, marrin masa për të shmangur papajtueshmërinë ambientale, sipas pikës 3, të këtij neni, me qëllim që të garantohet besimi i publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe paanësia e magjistratit, eficienta e gjykatave dhe zyrave të prokurorisë në dhënien e drejtësisë”*. Ndërkohë, kuptimi i papajtueshmërisë ambientale përcaktohet në pikën 1, të kësaj dispozite ligjore, sipas të cilës: *“Papajtueshmëria ambientale, në kuptimin e këtij neni, krijohet për shkak të lidhjeve të ngushta familjare mes magjistratëve, që janë përkatësisht bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë”*. Sa i takon rasteve të papajtueshmërisë ambientale për sa lidhet me ngritjen në detyrë në gjykatën e shkallës së dytë, ato parashikohen në pikën 3, shkronja “a”, të kësaj dispozite ligjore, ku përcaktohet se: *“Papajtueshmëri ambientale përbëjnë rrethanat e mëposhtme: a) nëse respektivisht në të njëjtën gjykatë ose prokurori ku magjistrati kërkon të caktohet, ushtron funksionin një magjistrat tjetër, që ndodhet në kushtet e pikës 1 të këtij neni”*.

32. Në lidhje me papajtueshmërinë ambientale, në rastin e aplikimit, në përputhje me detyrimin sipas nenit 8, pika 5, të Ligjit për Statusin, kandidatja ka depozituar formularin e Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale” datë 08.06.2020, nëpërmjet të cilës, përkundrejt përgjegjësisë ligjore, ka deklaruar se: *“Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”*.

33. Gjatë verifikimit nuk rezultoi ndonjë e dhënë e ndryshme nga ajo e deklaruar nga kandidatja në lidhje me situatën e papajtueshmërisë ambientale për sa ajo kandidon për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

34. Nga dokumentacioni i administruar gjatë verifikimit, Këshilli vlerësoi se për kandidaten znj. {...} nuk vërtetohet të ndodhet në situatën e papajtueshmërisë ambientale në rast të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë.

35. Duke vlerësuar të plotë procedurën dhe verifikimet e kryera për kandidaten znj. {...}, në lidhje me tre prej kritereve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit, atë të “përvojës profesionale minimale”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”, relatorja ia parashtrroi çështjen Komisionit të Zhvillimit të Karrierës i cili vendosi për kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur në lidhje me plotësimin ose jo të kandidates znj. {...} të këtyre kritereve, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit.

36. Ndërkohë, më datë 09.09.2020, bazuar në nenin 146 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar me Ligjin nr.101/2020 (miratuar më datë 23.07.2020, botuar në Fletoren Zyrtare nr.143, datë 4 Gusht 2020 dhe hyrë në fuqi më datë 19.08.2020), znj. {...} u përzgjodh me short si anëtare e Kolegjit Zgjedhor. Zgjedhja e saj në këtë detyrë u miratua me Vendimin nr. 293, datë 09.09.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Si rezultat i kësaj, ndërsa sipas shkronjës “b”, pika 1, të nenit 149, të këtij Kodi përcaktohej se “Gjyqtari gjatë ushtrimit të detyrës në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor nuk mund: ...; b) të lëvizet nga detyra në mënyrë të përkohshme apo të përhershme për shkaqe ... apo ngritje në detyrë”, procedura e verifikimit nuk vijoi në pritje të shqyrtimit nga Kuvendi i Shqipërisë të nismës ligjore, ndër të tjera, edhe për ndryshimin e kësaj dispozite. Me Ligjin nr.118/2020, u shfuqizua togfjalëshi “apo ngritje në detyrë”, në shkronjën “b”, pika 1, të nenit 149, të Kodit Zgjedhor. Ky ligj u botua në Fletoren Zyrtare nr.191, datë 3 nëntor 2020, duke hyrë ai në fuqi më datë 18.11.2020.

37. Në vijim, pas administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, duke çmuar se procedura e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për kandidaten {...} për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 181 dhe nr. 183 datë 28.05.2020 dhe për pozicionin e lirë, në fushën e së drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 185, datë 28.05.2020, ishte e plotë dhe në përputhje me kërkesat e Vendimit 75/2019, relatorja e çështjes e parashtrroi çështjen përpara Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

38. Në Mbledhjen e datës 20.11.2020, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të plotë procedurën e verifikimit të kandidates për në Gjykatën e Apelit Tiranë, znj. {...}, për kushtet dhe kriteret e kandidimit, bazuar në kërkesat e Vendimit 75/2019, si dhe në pikën 9, të Vendimeve të Këshillit nr. 181, nr. 183 dhe nr. 185, datë 28.05.2020, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar dhe vendosur për kualifikimin ose jo të kandidates znj. {...} në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 181 dhe nr. 183 datë 28.05.2020 dhe për pozicionin e lirë, në fushën e së drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 185, datë 28.05.2020.

39. Për rrjedhojë, me rënien e pengesës ligjore më datë 18.11.2020, shqyrtimi i rezultateve të verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për kandidaten {...} u përfshi në Mbledhjen Plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor të datës 29.12.2020.

III. REZULTATET E VERIFIKIMIT TË PASURISË DHE TË FIGURËS

35. Neni 48, pika 7 dhe pika 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), përcakton se: “7. Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji. 8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës ..., pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë”.

36. Ky përcaktim ligjor në lidhje me verifikimin e pasurisë dhe figurës së kandidatëve për ngritjen në detyrë, ndër të tjera edhe në gjykatat e apelit, është rregulluar më tej në aktin nënligjor të Këshillit, në Vendimin nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (në vijim referuar si Vendimi 75/2019). Pasur parasysh faktin se të gjithë gjyqtarët në detyrë, bazuar në nenin 179 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në Ligjin 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, janë subjekt rivlerësimi kalimtar “*ex officio*”, rivlerësim ky që përfshin edhe verifikimin e pasurisë dhe figurës, Këshilli parashikoi rregulla specifike për gjyqtarët subjekt rivlerësimi kalimtar që kandidonin për ngritjen në detyrë, sa i përkiste verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre.

37. Konkretisht, në Seksionin B, Kreu X, të Vendimit 75/2019, titulluar “Verifikimi i pasurisë dhe figurës së kandidatëve subjekt i procedurës së rivlerësimi kalimtar sipas ligjit nr. 84/2016”, përcaktohet se: “1. Kandidatët që i janë nënshtruar procedurës së rivlerësimi kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 dhe janë konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimi kalimtar, me vendim të formës së prerë, nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe të figurës sipas përcaktimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin. ... 3. Pavarësisht nga parashikimet e pikave 1 dhe 2 të këtij Seksioni, kandidatët subjekt i procedurës së rivlerësimi kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, do t’i nënshtrohen menjëherë procedurave të verifikimit të integritetit sipas Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”. 4. Procedura e përcaktuar në pikat 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, për verifikimin e integritetit të kandidatëve subjekt i procedurës së rivlerësimi kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, për kandidatët që i janë nënshtruar procedurës së rivlerësimi kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 dhe janë konfirmuar në detyrë nga organet e rivlerësimi kalimtar, shtrihet për periudhën pas asaj të datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimi kalimtar. ... 6. Nëse procedurat e verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidatëve subjekt i procedurës së rivlerësimi kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, fillojnë pas afatit 180 ditor të përcaktuar nga pika 2 e nenit 3/1 të Ligjit nr. 9049/2003, procedura e verifikimit të pasurisë së këtyre kandidatëve shtrihet mbi interesat pasurore, private dhe konfliktin e interesit, për periudhën pas asaj të datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimi kalimtar për konfirmimin e tyre në detyrë. 7. Kandidatët subjekt i procedurës së rivlerësimi kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, të cilët nuk janë konfirmuar në detyrë me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, edhe kur ndaj atij vendimi është paraqitur ankim, nuk pranohen të kandidojnë dhe nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve të tjera ligjore të kandidimit sipas pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin”.

38. Sa sipër, kandidatja për gjyqtare në Gjykatën e Apelit, për t'u kualifikuar për ngritjen në detyrë, do të duhet në çdo rast të kalojë me sukses verifikimin e pasurisë dhe të figurës. Megjithatë, në rastin e kandidatës që i është nënshtruar dhe ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", verifikimi për të i pasurisë dhe figurës sipas pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusin, do të shtrihet për periudhën pas datës që ka marrë formë të prerë vendimi i dhënë nga organet e rivlerësimit kalimtar.

39. Rezulton se kandidatja, znj. {...} i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, ndërsa është konfirmuar në detyrë me vendim përfundimtar, pikërisht me Vendimin nr. 86, datë 17.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit i cili është lënë në fuqi me vendimin nr. 8 datë 25.06.2020 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Për rrjedhojë, verifikimi i pasurisë dhe figurës për këtë kandidat u shtri për periudhën pas datës 25.06.2020, që ka marrë formë të prerë vendimi i organeve të rivlerësimit kalimtar për konfirmimin e tij në detyrë.

A. Për kriterin e pasurisë

40. Për kandidaten {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikat 7 dhe 8, të nenit 48 në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32¹, të Ligjit për Statusin, për periudhën pas dhënies së vendimit nga organet e rivlerësimit kalimtar.

41. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...}, u kërkua raportim nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI), i cili ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 204/23 prot., datë 29.09.2020.

41.1 Sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, kandidatja {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

¹ "2. ..., për secilin kandidat ..., Këshillat kërkojnë raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës në lidhje me çdo shkak tjetër përjashtues, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave, prokuroria, organet e administratës tatimore dhe doganore, Byroja Kombëtare e Hetimit, shërbimet shtetërore informative, si dhe çdo organ disiplinor që ka mbikëqyrur disiplinën në marrëdhëniet e punës së kandidatit. Nëse është e nevojshme, Këshillat kërkojnë informacion shtesë nga institucionet e përmendura në këtë pikë. 3. Çdo institucion publik, subjekt fizik ose juridik, duhet të përmbushë kërkesat e Këshillave për informacion, dokumentacion, ose materiale të tjera në lidhje me një hetim, me përjashtim të rasteve të kufizuara me ligj, brenda afatit ligjor të arsyeshëm të përcaktuar nga Këshillat në kërkesën e tyre. 4. Në çdo rast, kandidati nuk pranohet ... kur: a) raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave tregon që burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij dhe nuk ka deklaruar pasuri ose asete ose ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve; b) raportet e Byrosë Kombëtare të Hetimit ose Shërbimit Informativ Shtetëror tregojnë se kandidati ka lidhje me krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar"; c) ka ndonjë shkak tjetër përjashtues të njohur, të parashikuar sipas ligjit. 5. ..., Këshillat vendosin pranueshmërinë e kandidatëve, bazuar në informacionin që kanë marrë për rezultatet e verifikimit të pasurisë dhe figurës së tyre. ...".

41.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit janë kryer kontrolle të plota për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidatja {...}, për periudhën pas dhënies së vendimit nga ana e organeve të rivlerësimit, duke konkluduar se për kandidaten:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

42. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidaten {...} u kërkua informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

42.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni u dërgua me Shkresën nr. 13569/1 prot., datë 27.07.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr. 3348/1 prot., datë 29.07.2020, ku për kandidaten {...} rezulton të mos jetë i regjistruar për ushtrimin e ndonjë aktiviteti privat.

42.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me Shkresën nr. 13524/1 prot., datë 23.07.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr. 3347/1 prot., datë 24.07.2020, ku për kandidaten {...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

43. Në kushtet kur nga informacionet respektive të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nuk jepej ndonjë e dhënë me karakter pasuror për kandidatin, u vlerësua se nuk kishte vend për t'iu kërkuar ILDKPKI-së bërja e një kontrolli shtesë.

44. Po ashtu, referuar të të dhënave të përshkruara në Raportin e ILDKPKI-së, të nxjerra nga dokumentacioni i paraqitur nga vetë kandidatja, si dhe ai i administruar nga korrespondenca me subjekte shtetërore dhe private, dokumentacion që evidentohet hollësisht në Raport, sikundër dhe analizës financiare të bërë nga ky organ publik, përgjegjës për kontrollin e deklarimit të pasurive dhe konfliktit të interesave sipas Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik", i ndryshuar, nuk u konstatua paplotshmëri ose mangësi në raportim, shkak për të cilin u vlerësua se nuk kishte vend për raportim shtesë nga ky organ.

45. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidaten {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të kualifikimit ose skualifikimit të saj. Konkretisht, të dhëna në lidhje me:

- a) plotësimin, depozitimin ose jo nga kandidatja, të formularit të deklaratës së pasurisë;
- b) plotësimin, depozitimin ose jo nga kandidatja, të nënshkruara, të autorizimeve të kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) burimet financiare të kandidates dhe justifikimin ose jo të pasurisë së saj;
- ç) plotësinë, vërtetësinë dhe saktësinë ose jo, të deklarimit të pasurisë, aseteve ose të interesave private, të detyrueshme për t'u deklaruar.

B. Për kriterin e figurës

46. Për kandidaten {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikat 7 dhe 8, të nenit 48 në lidhje me pikat 2 deri në 7, të nenit 32, të Ligjit për Statusit, për periudhën pas dhënies së vendimit nga organet e rivlerësimit.

47. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...}, u kërkua raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit për Statusit, me përjashtim të Byrosë Kombëtare të Hetimit, e cila nuk ka filluar ende ushtrimin e funksioneve të saj pasi vetëm së fundmi Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka emëruar Drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit², ndërsa më datë 08.09.2020, janë hapur aplikimet për hetues të këtij institucioni³.

48. Nga raportimet e institucioneve ligjzbatuese nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidates {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e saj në veprimtari që çënojnë sigurinë kombëtare apo aktivite të kundërligjshme.

49. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidaten {...}, në kushtet kur kjo kandidate ka qenë magjistrat në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga ky ligj, kandidatja i është nënshtruar verifikimit sipas këtij ligji. Për rrjedhojë, informacioni iu kërkua Strukturës së Posaçme për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

50. Nga Struktura e Posaçme pranë Këshillit informacioni u dërgua me Shkresën nr. 3239/1 prot., datë 10.07.2020, ku për kandidaten {...} është bërë me dije se:

- ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 29.04.2016;
- formulari i vetëdeklarimit është bërë publik, në faqen zyrtare të ëeb;
- në formularin e vetëdeklarimit, nuk ka të deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji;
- nga përgjigjet e ardhura nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile, ka rezultuar ndryshim i të dhënave të gjendjes civile nga ato të deklaruara, me proces verbalin nr. 2003 datë 25.09.2006 është ndryshuar vendlindja nga Rrogozhinë, Durrës në Tiranë. Ky informacion është dërguar për verifikim pranë Prokurorisë së Përgjithshme e cila ka kthyer përgjigje.. se Sektori i Verifikimit të Integritetit, kryen verifikime të thelluara, në lidhje me vendime dënimi përfundimtarë apo jo, hetime, dëbime apo masa sigurimi penale të kryera brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe nëse kërkoni këtë dërgoni informacion në lidhje me indiciet për të kaluarën kriminale të subjekteve dhe arsyen pse kërkohet ky verifikim...apo gjendjes gjyqësore, nga ato të deklaruara;
- deri më sot nuk ka patur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme.

² Vendimi nr.183, datë 30.07.2020.

³ Sipas njoftimit në faqen zyrtare: <https://bkh.al/2020/09/08/njoftim-per-shpalljen-e-konkursit-per-pozicionet-hetues-ne-byrone-kombetare-te-hetimit/>

Për pasojë, u vlerësua që nuk kishte vend për verifikim shtesë nga Prokuroria e Përgjithshme.

51. Kandidatja znj. {...} nuk iu nënshtrua verifikimit të integritetit sipas Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar, në kushtet kur ai nuk është i vitlindjes më të hershme se Korrik 1977 (kandidatja është e vitlindjes 1979), sikurse përcaktohet në pikën 8, Seksioni B, Kreu IX, të vendimit 75/2019.

52. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidaten {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të kualifikimit ose skualifikimit të saj. Konkretisht, të dhëna në lidhje me:

- a) plotësimin, depozitimin ose jo nga kandidatja, të formularit të vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015;
- b) plotësimin, depozitimin ose jo nga kandidatja, të nënshkruara, të autorizimit për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e saj;
- c) ekzistencën ose jo të lidhjeve ose kontakte të papërshtatshme të kandidates me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- ç) qenien ose jo të kandidates, anëtare, bashkëpunëtore ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar;
- d) qenien ose jo të kandidates, bashkëpunëtore, informatore ose agjente e shërbimeve të inteligjencës;
- dh) ekzistencën ose jo të dhënave të tjera në lidhje me figurën dhe integritetin e kandidates, mbi të cilat mund të gjykohej për pranueshmërinë ose jo të saj për emërimin si gjyqtare në Gjykatën e Apelit Tiranë.

III. KONKLUZIONE

53. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë për kandidaten znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

54. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë për kandidaten znj. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidatja i përmbush ato, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin dhe refuzimin e emërimit të saj. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidates dhe vijimin e procedurave të ngritjes në detyrë në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 181 dhe nr. 183 datë 28.05.2020 dhe për pozicionin e lirë, në fushën e së drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 185, datë 28.05.2020.

PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në shkronjën “a” të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 4, të nenit 47, në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “dh”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I :

1. Kualifikimin e kandidates znj. {...} dhe vijimin e procedurave të emërimit në Gjykatën e Apelit Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e së drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 181 dhe nr. 183 datë 28.05.2020 dhe për pozicionin e lirë, në fushën e së drejtës penale, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 185, datë 28.05.2020.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidates znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqjen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR